



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 118 - Prill 2013 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga ndërtimi i muzeut dhe sahat kullës në qytetin e Malishevës



Pamje nga riparimi i mullirit ne Banjë



Pamje nga zgjerimi i rrugëve në hyrje daljet e Malishevës



Përmbajtja:

U shënua Dita e Ambientit, duke e pastruar qytetin	3
Komuna e gatshme për spërkatjen e zonave endemike.....	3
Kilaj e Basha, diskutuan mundësinë e zgjerimit të shërbimit për menaxhimin e mbeturinave	4
Premtohet maksimumin për trajtimin e etheve hemorragjike	5
Filloi fushata e spërkatjes së zonave endemike	7
U mbajt punëtorja për definimin e skenarëve të zhvillimit hapësinor	8
USAID-DEMI mbështet komunën në joshjen e investitorëve	9
Mbahet Dita e Kulturës Çame (Çamëria është gjallë)	10
Janë duke u realizuar shumë projekte në Malishevë	12
Rregullohen hyrje daljet e qytetit në Malishevë	13
Parqet dhe varrezat në Malishevë, do ti menaxhoj “Ekoregjioni”	14
KK miratoi raportin e punës së Kryetarit dhe Qeverisë Komunale për vitin 2012	15
Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi katër çështje për mbledhjen e KK-së	16
Kryetari Kilaj me disa kërkesa urgjente për KEK-ut	16

U shënua Dita e Ambientit, duke e pastruar qytetin

Malishevë, 2 prill

Me anë të aksionit për pastrimin e qytetit të Malishevës, sot është shënuar Dita Ndërkombëtare e



Ambientit. Në këtë aksion kanë marrë pjesë, punëtorët e administratës komunale të Malishevës, të prirë nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, pastaj nxënësit e të gjitha shkollave në Malishevë, si dhe ekipi i misionit të OSBE-së në Malishevë.

Përveç pastrimit të rrugëve dhe parkut të qytetit, gjatë këtij aksioni, janë mbjellë edhe drunjt në parkun e qytetit.

Aksioni ka filluar nga ora 10:00 e paradites dhe ka zgjatur rreth dy orë. Këtij aksioni i ka paraprirë edhe një fushatë vetëdijesimi.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Komuna e gatshme për spërkatjen e zonave endemike

Malishevë, 8 prill

Qeveria komunale e Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të saj, të drejtuar nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, në të cilën janë diskutuar një varg çështjesh me rëndësi, në mesin e tyre edhe përgatitjet për fillimin e spërkatjes selektive të zonave endemike, si masë parandaluese nga thumbimi i rriqrave dhe etheve hemorragjike.

“Janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e fushatës së spërkatjes selektive të 39 zonave të evidentuara, si zona endemike, kundër rriqrave, si masë parandaluese nga infektimi me ethe hemorragjike. Për këtë vit, janë paraparë të bëhet spërkatje në dy faza, dhe sipas nevojës edhe më shumë, përderisa është dyfishuar si preparati për spërkatje, ashtu edhe kapacitetet njerëzore dhe tërë kësaj fushate, i paraprinë edhe fushata e vetëdijesimit përmes ligjëratave dhe njoftimeve përmes medieve”, ka bërë të ditur drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, z.Skënder Hoti. Sipas drejtorit Hoti, fushata është paraparë të filloj me 15 prill, por kjo varet nga kushtet atmosferike.

Çështje tjetër e ngritur nga kryetari Kilaj, ishte edhe bllokimi i rrugës në hyrje të Malishevës (rruga për Banjë) nga uji, si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut. Sipas drejtorëve përgjegjës, deri te ngritja e nivelit të ujit në atë pjesë, vjen si pasojë e një ndërtimi pa leje, për të cilën lënda është e proceduar në gjykatë dhe problem tjetër është niveli i ulët i asaj pjese në raport me rrjedhën e lumit Mirusha. Për këtë çështje, kryetari Kilaj, kërkoi zgjidhje të shpejtë dhe të përhershme, përderisa është duke u shikuar edhe mundësia vendosjes së një gypi shkarkues të ujit, në mënyrë që të mos bllokohet rruga Malishevë-Banjë.

Një çështje tjetër problematike, e ngritur edhe në mbledhjen sotme, ishte edhe çështja e rrëshqitjes së dheut në Tërpezë të Ulët, ku u bë e ditur, se gjatë javës, këtë vend do të vizitojnë edhe një ekip ekspertësh nga FSK-ja, në mënyrë që e edhe FSK-ja të jep kontributin e saj, në zgjidhjen e përhershme të këtij problemi.

Kryetari Kilaj, në mbledhjen e sotme, kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të mbillen drunj dekorativ – fidane, të mëdha në mënyrë që të mos dëmtohen, si dhe kërkoi që të vendosen kontejner të vegjël, për mbeturina të imta, në tërë qytetin.

Kryetari Kilaj, po ashtu, kërkoi, që të ndihmohet me një komplet ndihmash, një familje në fshatin Carrallukë, e cila ka mbetur pa përkujdesje.

Kilaj e Basha, diskutuan mundësinë e zgjerimit të shërbimit për menaxhimin e mbeturinave

Malishevë, 12 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot drejtorin ekzekutiv të kompanisë për menaxhimin e mbeturinave “Ekoregjioni”, z.Nehat Basha, me të cilin kanë diskutuar mundësitë e zgjerimit të shërbimit të njësisë në Malishevë, për grumbullimin e mbeturinave, në tërë territorin e Komunës së Malishevës.



“Jemi të kënaqur me shërbimin e njësisë së “Ekoregjionit”, për grumbullimin e mbeturinave, në 13 vendbanimet, që aktualisht e ka shtrirjen kjo njësi. Si rezultat i kësaj pune, ne kërkojmë që të zgjerohet ky shërbim në të gjitha vendbanimet e komunës së Malishevës”, ka kërkuar kryetari Kilaj. “E keni edhe mbështetjen e komunës, në çdo aspekt, në mënyrë që këtë shërbim ta kenë të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës”, tha Kilaj.

“Ne si kompani regjionale, jemi të kënaqur me njësinë në Malishevë dhe objektiv i yni, është zgjerimi i shërbimit”, tha drejtori ekzekutiv i “Ekoregjioni-t”, z.Basha. Ai më pas premtoi se do të bëjnë gjithçka që është e mundur, që shërbimi i grumbullimit të mbeturinave, gradualisht të shtrihet në tërë territorin e Komunës së Malishevës, pasi njësia në Malishevë, është njësia më e mirë.

Kilaj e Basha, po ashtu u pajtuan që të bashkëpunojnë edhe në aksione të përbashkëta për pastrimin e ambientit, si dhe në largimin e mbeturinave inerte.

Premtohet maksimumin për trajtimin e etheve hemorragjike

Malishevë, 12 prill

Sot në Malishevë, kanë qëndruar përgjegjësit e institucioneve përgjegjëse, të cilat merren me trajtimin e etheve hemorragjike, përkatësisht përgjegjësit e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) dhe të Klinikës Infektive të QKUK-së, të cilët janë takuar me Kryetarin e Komunës, z.Isni Kilaj, ku janë zotuar se do të bëjnë maksimumin për trajtimin e etheve hemorragjike, nëse paraqitet nevoja e trajtimit.



Nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, ishte drejtori z.Naser Ramadani dhe Nurishahe Hulaj nga Instituti Regjional i Shëndetit Publik, pastaj Dr.Shemsedin Dreshaj, drejtor i Klinikës Infektive, bashkë me Dr.Salih Ahmetin, infektolog në këtë klinikë dhe Dr.Isuf Dedushaj, epidemiolog.

Fillimisht kryetari Kilaj, i falënderoi ekspertët jo vetëm për vizitën, por edhe për mbështetjen e vazhdueshme, që Klinika Infektive dhe IKSHP-ja, i kanë dhënë Malishevës, në trajtimin e etheve hemorragjike. “Ne kemi dyfishuar kapacitetet tona për këtë vit, për realizimin sa më të mirë të fushatës së spërkatjes të zonave endemike”, tha kryetari Kilaj.

“Muaji prill, është muaji që vlerësohet më i rrezikshëm, ku mundësia e infektimit me ethe hemorragjike, është më e madhe, për shkak se rriqrat, si bartës të këtij infeksioni janë shumë aktiv, por ne si Klinikë Infektive, do të jemi në përkrahje dhe mbështetje tuajën, për menaxhimin sa më të mirë të rasteve eventuale”, tha drejtori i Klinikës Infektive, dr.Shemsedin Dreshaj, i cili lavdëroi angazhimin e komunës, për luftimin e kësaj sëmundje.

Edhe infektologu, Dr.Salih Ahmeti, tha se është bërë shumë nga ana e komunës. “Falë këtyre fushatave që keni bërë, bazuar në të dhënat, me rastet e infektuara, numri i vdekjeve është shumë i ulët, pasi mundësitë e fatalitetit nga infektimi me ethe hemorragjike, është shumë i madh. Andaj unë përgëzoj për këtë punë të mrekullueshme që keni bërë si komunë”, tha Dr. Ahmeti.

Ndërsa epidemiologu Dr. Isuf Dedushaj, pritjet vërtet kanë qenë, të numri i rasteve të prekura me ethe hemorragjike, por edhe rasteve që përfundojnë me vdekje, kanë qenë që numri të jetë shumë më i lartë, pro falë punës në terren, kjo është zvogëluar në maksimum. “Është punuar shumë në këtë drejtim, si nga ju në terren, po ashtu edhe nga ana e ekspertëve”, tha Dedushaj.

Edhe përgjegjësi i IKSHP-së, z.Naser Ramadani, i ka quajtur të mira dhe efektive masat e ndërmarra deri tani, si nga ana e Komunës së Malishevës, ashtu edhe nga IKSHP-ja, pasi janë treguar rezultate të mira në parandalimin e infektimit me ethe hemorragjike.

“Fushata e luftimit të etheve hemorragjike, zyrtarisht fillon sot me ligjërata për trajtimin e etheve hemorragjike dhe rriqrave, që do të mbahet në QKMF në Malishevë”, tha drejtori i QKMF-së, z.Besim Zogaj. Drejtori Zogaj, bëri të ditur se deri më tani, për këtë vit, janë regjistruar 15 raste të thumbit nga rriqrat, por asnjë rast nuk është hospitalizuar ose infektuar.

Ndërsa drejtori komunal për shëndetësi, z.Skënder Hoti, i cili paralajmëroi se me 15 prill do të filloj fushata e spërkatjes së zonave endemike, fajësoi Ministrinë e Shëndetësisë, për mospërkrahje në këtë drejtim. Hoti, bëri të ditur, se kjo fushatë, do të bëhet në dy faza, ku do të bëhet dezinfektimi, dezinfektimi dhe derratizimi, i zonave endemike.

Të gjithë, në këtë takim, u pajtuan se QKMF-së në Malishevë, i duhet një aparat i hemogramit, për bërjen e analizave të shpejta, për rastet e thumbuara nga rriqrat, me çka edhe do të mundësohej që rastet eventuale të prekura nga ethet hemorragjike, të kuptoheshin më shpejt dhe rrjedhimisht edhe trajtimi i tyre të bëhej më shpejt dhe më sigurt.

Filloi fushata e spërkatjes së zonave endemike

Malishevë, 16 prill

Sot, në orët e para të mëngjesit, ka filluar spërkatja e zonave të evidentuara si zona endemike,



kundër rriqrave, të cilat janë bartës të virusit i cili shkakton ethet hemorragjike. Spërkatja e këtyre 39 zonave endemike, është masë parandaluese kundër infektimit me virusin etheve hemorragjike.

fushatë të dezinfektimit.

Komuna e Malishevës, këtë vit, përveç që ka nisur shumë më herët këtë fushatë, ka rritur edhe numrin e personelit të angazhuar si dhe ka rritur sasinë e preparatit, për këtë

Sipas drejtorit për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj dhe atij për Shëndetësi, z.Skënder Hoti, si bartës të këtij projekti, “sasia e preparatit, për këtë vit është 500 litra, e mjaftueshme për zhvillimin e dy fazave të dezinfektimit, si dhe numri i personelit, është rritur në 30 persona të angazhuar, si dhe angazhimi i makinerisë për spërkatje të gjerë”.

Fushata e spërkatjes së zonave endemike, po mbikëqyret nga Instituti Rajonal i Shëndetit Publik (IRSHP) në Prizren, ndërsa në ditët në vijim, sipas drejtorit Hoti, pritet të marrë pjesë edhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP), me mjetet e saj për dezinfektim të hapësirave më të zgjeruara.

Hoti e Zogaj, thanë se “përveç fushatës së spërkatjes së zonave endemike, po bëhen edhe fushata tjera vetëdijesimi, kryesisht nëpër shkolla dhe përmes shpërndarjes së broshurave.

Fillimi shumë e hershëm i kësaj fushate, është vlerësuar i nevojshëm nga ana e organeve përgjegjëse, si dhe epidemiologëve dhe infektologëve vendës, pasi në fazën e parë bëhet asgjësimi i rriqrave në fazën e zhvillimit, ndërsa në fazën e dytë, bëhet në kohën kur rriqrat vetëm zhvillohen dhe si rezultat, këtë vit, parashihet të ketë më pak raste të thumbimit, por edhe të infektimit.

Sipas IKSHP-së, IRSHP-së dhe epidemiologëve vendas, Komuna e Malishevës, është e vetmja komunë, ku tash e disa vite, komuna del jashtë mundësive të saj, në mbrojtje të shëndetit të popullatës së saj, përderisa e njëjta gjë nuk bëhet në rajonet apo komunat tjera në vend.

Këtë vit, pritet që përveç dezinfektimit të bëhet edhe derratizimi dhe dezinfektimi i zonave të caktuara endemike.

U mbajt punëtorja për definimin e skenarëve të zhvillimit hapësinor

Malishevë, 17 prill

Për dy ditë radhazi, u mbajt punëtorja për definimin e skenarëve të zhvillimit hapësinor, në kuadër të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK). Kjo punëtori, është mbajtur me qëllim të angazhimit të palëve kryesore të interesit, duke përfshi edhe shoqërinë civile për të definuar skenarët e zhvillimit hapësinor, ndërsa rezultatet e kësaj punëtorie, do të jenë bazë për hartimin e fazës së tretë të Planit Zhvillimor Komunal.



Punëtorja, është organizuar nga Komuna e Malishevës dhe Programi për Përkrahje të Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP), program i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe implementuar nga UN-Habitat-i.


Në këtë punëtori u punua dy ditë, në tri grupe të ndara, në tre skenarë: në skenarin i Koncentruar, Policentrik dhe Asetet (pasuritë) bazë, ndërsa në fund të punimeve, është bërë edhe

prezantimi i secilit skenarë veç e veç.

Në fund të punëtorisë, ku kanë marrë pjesë ekspert të fushave përkatëse nga niveli komunal, ekspertë nga UN-Habitat-i dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, z. Esat Paçarizi, i falënderoi të gjithë për kontributin e dhënë.

USAID-DEMI mbështet komunën në joshjen e investitorëve

Malishevë, 18 prill



Programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive i USAID-it (DEMI), ka dorëzuar një varg materiale për komunën, që janë rezultat i bashkëpunimit me administratën e Komunës së Malishevës, me qëllim të mbështetjes së Zhvillimit Ekonomik Lokal proaktiv, ku përmes këtyre materialeve, synohet joshja e investitorëve në Malishevë.

Në letërën pranim/dorëzimit, e cila është e nënshkruar nga drejtorja e DEMI



programit të USAID-it, Ginka Kapitanova dhe Kryetarit të Malishevës, Isni Kilaj, mes tjerash thuhet: “administrata juaj ka qenë partnere dhe mbështetëse e rëndësishme në procesin e krijimit të këtyre arritjeve dhe besoj fuqishëm, që këto materiale do t’ju ndihmojnë në përpjekjet e juaja për të pasur qëndrim proaktiv në zhvillimin ekonomik lokal”.

Materialet, e dorëzuara nga USAID-DEMI për Komunën e Malishevës, e të cilat janë punuar në bashkëpunim mes Komunës dhe USAID-it-DEMI-it, janë: Udhëzues për Investitorë, broshura, një baner, publikime dhe pako trajnimi për Zhvillim Ekonomik Lokal.

Këto materiale, do të vendosen në vende të dukshme për të promovuar komunën, pastaj do të uest fagen e komunës, si dhe broshurat do t’ju shpërndahen investitorëve apo personave të tjerë me ndikim për joshjen e investitorëve, me qëllim të joshjes për të investuar në Malishevë.

Këto materiale, përmbajnë të dhënat bazike për Komunën e Malishevës, fushat e interesit të komunës, si transporti dhe shërbimet publike, administratën komunale, procedurat e regjistrimit të bizneseve, resurset natyrore, avantazhet kompetitive dhe cilësinë e jetës.

Mbahet Dita e Kulturës Çame (Çamëria është gjallë)

Malishevë, 19 prill

Sot, në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, është zhvilluar aktiviteti kulturor Dita e Kulturës Çame (Çamëria është gjallë), ku është shfaqur një ekspozitë me fotografi, pastaj prezantimi i krijimtarisë së autorit të njohur çam Namik Selmani, si dhe është shfaqur një dokumentar për Çamërinë.



Duke e përshëndetur këtë aktivitet, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, tha se “ne kemi mall për Çamërinë”. “Është ndjenjë e veçantë, për temën që na sjell poeti Selmani, për Çamërinë. Dikur ka qenë një ëndërr , ndërsa sot një realitet, që ne sot jemi të bashkuar”, tha mes tjerash i pari i Malishevës, Isni Kilaj.

Edhe autori Namik Selmani, falënderoi Komunën e Malishevës për këtë organizim, përderisa shpjegoi edhe ekspozitën, me foto grafi çame, ku në mënyrë kronologjike, ishte paraqitur kultura çame, shtypja greke ndaj çamëve, vrasjet dhe përpjekjet çame për mbijetesë. Autori Selmani, po ashtu prezantoi edhe krijimtarinë e tij letrare, me dhjetëra botime, kryesisht për Çamërinë.

Para shfaqjes së dokumentarit, autorja vendase, znj.Mihane Hoxha, prezantoi punën e autorit Namik Selmani, shkrimet e tij dhe lidhjen e tij me Kosovën në përgjithësi dhe në veçanti me Malishevën. Poetja Mihane Hoxha, ishte edhe nismëtare e këtij aktiviteti të madh kulturorë dhe historik.

Për çështje çame, një prezantim e bëri edhe autori Izet Shala, me një botim të bërë vite më parë, për këtë çështje.

Në fund të aktivitetit, u shfaq edhe dokumentari për Çamërinë, ku u paraqit në tërësi çështja çame, ku përmes këtij dokumentari, faktohet ekzistenca çame në trojet e sotme të aneksuara nga grekët, që nga kohët e para erës së re, e deri në ditët e sotme, si dhe përpjekjet çame për mbijetesë dhe mos harresë të identitetit.

Ky aktivitet u organizua nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

Janë duke u realizuar shumë projekte në Malishevë

Malishevë, 22 prill

Sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, i cili i ka njoftuar drejtorët komunal, për projektet e shumta, të cilat janë në realizim e sipër, si dhe për disa projekte tjera të cilat pritet të fillojnë të realizohen së shpejti, e që kanë të bëjnë, kryesisht me infrastrukturën në Komunën e Malishevës.

Sipas Kryetarit të Komunës, aktualisht, janë duke u punuar rrugët, në tri hyrje daljet e Malishevës, përderisa shumë shpejt pritet të filloj edhe largimi i dheut, që ka rrëshqitur, në hyrjen veriore të Malishevës, afër tregut të veturave.

“Po ashtu është duke u punuar në ndërtimin e shkollës në Vërmicë, përderisa shumë shpejt pritet të tenderohet edhe ndërtimi i shkollës në Shkozë, ndërsa kanë përfunduar të gjitha procedurat për meremetimin komplet të shkollës në Bellanicë, si dhe besoj që shumë shpejt, do të filloj edhe ndërtimi i shkollës në Damanek (projekt që do të financohet nga donatorët tjerë)”, tha kryetari Kilaj. “E kur jemi te shkollat, janë duke u rregulluar fushat e sportit për katër shkolla, në Tërpezë, Astrazup, Drenoc dhe Pagarushë, si dhe presim që shumë shpejt të rregullohet sistemi i ngrohjes për shkollat në Dragobil dhe Guncat”, tha Kilaj.

Kryetari Kilaj, po ashtu bëri të ditur, se aktualisht, është duke u rregulluar trotuari në fshatin Astrazup, meremetimi i mullirit të Begajve në Banjë, përderisa janë në pritje, dhe në rrugë të mirë, për fillimin e ndërtimit të ujësjellësit për fshatin Drenoc, pasi është siguruar burimi i ujit, si dhe janë në pritje të ndërtimit të disa rrugëve nëpër fshatra.

“Investimet nuk mungojnë as në fushën e sportit, pasi jemi pajtuar ta ndihmojmë klubin e basketbollit KB “Malisheva” për pjesëmarrje në kampionatin kosovar të basketbollit, në ligën e parë, e po ashtu do të investojmë edhe në futboll, përkatësisht në klubin e futbollit, për pjesëmarrje në garat në nivel vendi”, tha i pari i Malishevës, z.Isni Kilaj.

Në fund u bë e ditur, se është duke vazhduar sipas planit edhe fushata e spërkatjes së zonave endemike, në kuadër të masave parandaluese, kundër infektimit nga ethet hemorragjike, virus i cili bartet nga rriqrat.

Rregullohen hyrje daljet e qytetit në Malishevë

Malishevë, 23 prill



Në kuadër të përmbushjes së projekteve kapitale për vitin 2013, Komuna e Malishevës, në mesin e dhjetëra projekteve që janë duke u realizuar, po rregullohen edhe rrugët dhe trotualet në tri hyrje daljet e qytetit të Malishevës, duke lehtësuar lëvizjen e qytetarëve dhe veturave, që hyjnë dhe dalin nga Malisheva, ka bërë të ditur, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e fundit të Këshillit të Drejtorëve.

Rruga që shpie në Banjë dhe në drejtim të “rrugës së kombit”, është duke u zgjeruar deri në dalje apo hyrje të Malishevës, ku po rregullohen trotualet në të dy anët e rrugës, si dhe do të rregullohet edhe ndriçimi në këtë pjesë, ku përmes së kësaj lehtësohet qarkullimi, kur merret parasysh edhe qarkullimi i madh i veturave të cilat lëvizin në drejtim të rrugës së kombit. Kosto e projektit, është rreth 60 mijë euro.

Rrugë tjetër, që është duke u rregulluar, është ajo në drejtim të fshatit Dragobil, saktësisht rruga që lidh Malishevën me Rahovecin (nga rruga e gjimnazit dhe QKMF-së, , deri tek rruga për Qendrën e Kompetencës dhe Shtëpisë së Kulturës). Në këtë rrugë, janë rregulluar trotualet, ndërsa tani është duke asfaltuar edhe pjesa e zgjeruar e rrugës, e cila lehtëson lëvizjen dhe qarkullimin e qytetarëve dhe veturave, në këtë pjesë. Kosto e këtij projektit, është rreth 25 mijë euro.

Një rrugë tjetër, mjaft e rëndësishme, në hyrje dhe dalje, që është duke u punuar në të është edhe rruga në drejtim të Mirushës, apo rruga Malishevë-Kijevë, ku është duke u bërë rregullimi i kësaj rruge, mjaft të rëndësishme dhe shumë të ngarkuar. Kjo rrugë, përveç rëndësisë që ka si hyrje dhe dalje në qytet, po ashtu kjo rrugë të shpie edhe në drejtim të liqenit “Mirusha” dhe ujëvarave të Mirushës. Kosto e rregullimit të kësaj rruge, është mbi 64 mijë euro.

Në mbledhjen e fundit të qeverisë komunale, u bë e ditur, se shumë shpejt, do të filloj edhe largimi i dheut në rrugën që dërgon në drejtim të Prishtinës, pasi ka pasur rrëshqitje dheu në këtë pjesë. Përveç largimit të dheut, parashihet edhe sigurimi i rrugës nga rrëshqitjet e dheut.

Parqet dhe varrezat në Malishevë, do ti menaxhoj “Ekoregjioni”

Malishevë, 24 prill

Komuna e Malishevës dhe njësia e “Ekoregjioni”-it në Malishevë, sot kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, për mirëmbajtjen e parkut të qytetit në Malishevë, parkut të liqenit në Mirushë, varrezave të Dëshmorëve në Malishevë dhe varrezave të Dëshmorëve në Kleçkë.

Me anë të kësaj marrëveshje, e cila është nënshkruar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe u.d. i drejtorit të njësisë operative të KRM “Ekoregjioni”, në Malishevë, z.Faik Krasniqi, hyn në fuqi nga sot, dhe kësaj të fundit i barten kompetencat e menaxhimit të këtyre dy parqeve dhe varrezave të Dëshmorëve. Kjo marrëveshje është arritur, me qëllim të menaxhimit më të mirë të parqeve dhe varrezave.

Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar, “Ekoregjion”-i, do të kujdeset për pastrimin e mbeturinave, ujitjen e parqeve, prerjen e barit, mbjelljen e drunjve dekorativ dhe ndriçimin e parkut “Sheshi i Dëshmorëve” në qytetin e Malishevës, parkut në Liqenin Mirusha, si dhe Varrezave të Dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë.

Po ashtu në bazë të kësaj marrëveshjeje, për të gjitha këto shërbime, komuna do të kujdeset për mbulimin e kostos financiare.

KK miratoi raportin e punës së Kryetarit dhe Qeverisë Komunale për vitin 2012

Malishevë, 25 prill



Asambleja Komunale e Malishevës, në mbledhjen e mbajtur sot, të katërtën për këtë vit, e ka shqyrtuar, ka debatuar dhe në fund e ka miratuar raportin vjetorë të punës, së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale në Malishevë, për periudhën janar-dhjetor 2012.

Para këshilltarëve komunal, raportin e punës së tij dhe të qeverisë komunale, e ka prezantuar Kryetari i Komunës,

z.Isni Kilaj, i cili theksoi se “buxheti komunal për vitin 2012, është shpenzuar në mënyrë të duhur, Komuna nuk ka borxhe, përjashtuar projektet dyvjeçare, por të cilat kanë qenë të planifikuara edhe me buxhet, të gjitha shërbimet kanë qenë në nivel të kënaqshëm, janë tejkaluar të hyrat nga tatimi”, si dhe ka prezantuar me rend të gjitha projektet e realizuara gjatë vitit 2012, si dhe projektet që aktualisht janë duke u realizuar.

Pas prezantimit të raportit, këshilltarët komunal kanë debatuar rreth raportit, si dhe kanë parashtruar pyetje për çështje të caktuara që lidhen me punën e Kryetarit dhe Qeverisë Komunale, pyetje të cilave, ju ka dhënë përgjigje Kryetari i Komunës. Në fund me 16 vota për, 8 kundër dhe një abstenim, është miratuar raporti i punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale, për vitin 2012.

Me shumicë të votave, të këshilltarëve komunal, është miratuar propozim-vendimi i Kryetarit të Komunës, për caktimin e deponisë së mbeturinave inerte, e cila do të jete mes fshatrave Panorc dhe Llapqevë, kurse sqarimet për këtë lokacion dhe çështjet tjera rreth kërkesës, i ka dhënë vet Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj.



Në mbledhjen e sotme, po ashtu është marrë vendim, për vazhdimin e mbështetjes për familjet e dëshmorëve, nga ana e Komunës së Malishevës. Ky vendim, është marrë me votim unanim nga të gjithë këshilltarët komunal, prezent në mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi katër çështje për mbledhjen e KK-së

Malishevë, 29 prill

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Asamblesë Komunale të Malishevës, i udhëhequr nga kryesuesi i Asamblesë Komunale, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e katërt për këtë vit, ku janë trajtuar dhe janë rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë, katër çështje.

Pas miratimit të rendit të ditës, dhe shqyrtimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, anëtarët e KPF-së, ka shqyrtuar dhe kanë rekomanduar për Kuvend, raportin tremujor të të hyrave dhe shpenzimeve, për periudhën Janar-Mars 2013.

Po ashtu për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, KPF-ja, pas shqyrtimit, ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë Komunale, projekt rregulloren për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoha Komunale, për vitin 2013.

Për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, është rekomanduar për shqyrtim dhe Plani i Punës së zyrës së Prokurimit për vitin fiskal 2013, si dhe draft-plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Kryetari Kilaj me disa kërkesa urgjente për KEK-ut

Malishevë, 30 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot në zyrën tij, zyrtarët e lartë të KEK-ut, përkatësisht z.Avni Alidemaj, drejtor ekzekutiv i rrjetit dhe z.Naim Sahiti, drejtor ekzekutiv për furnizim në KEK, të cilëve ju ka parashtruar disa kërkesa urgjente për rrjet në Komunën e Malishevës dhe një shqetësim për një ndërprerje të rrymës, për institucionet.

“Jam shumë i pakënaqur me sjelljen e përgjegjësit KEK-ut, i cili kishte vendosur për ndërprerjen e rrymës për

institucionet publike, përfshi edhe shkollat, e që kishte të bëjë me një borxh vetëm për faturën e fundit”, tha kryetari Kilaj, duke shprehur shqetësimin e tij, për atë formë të ndërprerjes së rrymës. “Ky person, është tendencioz dhe i ndikuar politikisht në veprimet e tij në raport me institucionet, pasi Komuna e Malishevës, asnjëherë nuk i ka mbetur borxh KEK-ut, andaj edhe kërkoi që ju ta shqyrtoni sjelljen e atij zyrtari të KEK-ut”, tha Kilaj.

Ndërprerja e furnizimit me rrymë, kishte ndodhur në fund të muajit mars, ndërsa problemet më të mëdha janë paraqitur në shkollat e Komunës së Malishevës, të cilat kryesisht furnizohen me ujë, përmes pompave.

Lidhur me këtë shqetësim, zyrtarët e lartë të KEK-ut kanë thënë se “do ta shqyrtojnë këtë shqetësim serioz të kryetarit, në raport me atë zyrtar përgjegjës për KEK-un për Malishevë”.

Më pas kryetari Kilaj, ju ka parashtruar disa kërkesa urgjente zyrtarëve të lartë të KEK-ut, e të cilat, kanë të bëjnë me largimin e disa shtyllave në dy rrugë kryesore në Malishevë, pastaj furnizime me transformator në disa fshatra, legalizimin e një trafo afër stadiumit të qytetit, për nevoja të stadiumit dhe furnizimin me shtylla betoni për dy fshatra, kërkesa për të cilat ka investuar edhe komuna në pjesën e saj, për realizimin e këtyre nevojave.

Drejtorët ekzekutiv Sahiti dhe Alidemaj, kanë premtuar se do angazhohen maksimalisht për realizimin e shpejt të kërkesave, të cilat në fakt edhe zyrtarisht ishin bërë më herët në adresë të KEK-ut.